



Kryeredaktor: Erl MURATI

Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



## KORÇA

... edhe sot më e mira

Hotel, Spa & Aquapark

Viti XXIX - Nr. 82476 E hënë 17 Janar 2022 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Nga ABDULLAH EREN

Të flasësh për marrëdhëniet ndërmjet Turqisë dhe Shqipërisë, duhet patjetër të flasësh për miqësinë shekullore tonën. Ne kemi një histori të përbashkët... **Vijon në faqen 20**

Vizita e presidentit të Turqisë në Shqipëri: Bashkë në një histori, bashkë në një të ardhme



Opinion

Ditës

Nga BEN ANDONI

Është për t'u habitur sesa buzagaz dalin politikanët shqiptarë kur akuzojnë, thërrihen për të pyetur apo japin shpjegime në Prokurori. Daljet e fundit të Berishës... **Vijon në faqen 21**

Parabola e Kafkës që i bën politikanët të dalin buzagaz nga prokuroria!



Presidenti turk, zbardhet agjenda 9-orëshe

## Erdogan në Shqipëri, vizitë te shtëpitë e rindërtuara në Laç dhe fjalim në parlament

Nga vizitat te nënshkrimi i marrëveshjeve. Rriten masat e sigurisë, bllokohen akset e rëndësishme rrugore

Recep Tayip Erdogan, presidenti turk do të vizitojë Rrsot Shqipërinë. Me rastin e vizitës së presidentit Erdogan përgjatë ditës së sotme do të bllokohen disa akse rrugore. Për të rritur masat e sigurisë, policia ka njoftuar bllokimin e disa prej akseve më të rëndësishme si autostrada Tiranë-Durrës si dhe aksi Vorë-Rinas, që nga ora 11:00 deri në 13:00 të ditës së nesërme.....

Në faqen 4

KRYETARI I PD NE FIER: ENDRRA PER TA BERE SHQIPERINE SI GJITHE EUROPA KA MBETUR E PAREALIZUAR

## BASHA, DEMOKRATEVE: JO DOREZIM PARA "TREKENDESHIT TE BERMUDES"

"Ditë e mrekullueshme mes demokratëve të Fierit, të çliruar nga hijet e të shkuarës dhe dinozaurët e tranzicionit që për shumë gjatë na kanë mbajtur peng. Demokratët kanë zgjedhur të ardhmen, ne do të sjellim ndryshimin që shqiptarët duan dhe meritojnë"



(Në foto) Kryetari i PD Lulzim Basha

Në faqen 3

METIMET

Laboratorë droge dhe falsifikim dokumentesh, brenda 1 jave u arrestuan 35 persona në gjithë vendin

Në faqen 7

RAPORTI

"Lulëzimi i kriptomonedhave", Shqipëria në vendin e 94, mban një shumë prej 15 mld dollarë

Në faqen 6

PANDEMIA

Rritet numri i infektiveve me COVID, regjistrohen 1697 raste të reja

Në faqen 10

EMRAT

Legalizimet, Kadastra zbardh listën e re të pronarëve për Tiranën

Në faqen 22

SI BENEË APLIKIMI



Si të përfitoni pension më të lartë, kërkesa që duhet të plotësojnë të moshuarit

Në faqen 9

Komplikimet mund të përfshijnë aspirimin, pneumoni, dehidrim dhe humbje peshe

## Simptomat kryesore që tregojnë se vuani nga disfagia

Trajtimi logopedik, për vështirësinë në gëlltitje

Nga GENTJANA SINAJ

Disfagia është vështirësia në gëlltitje. Njerëzit me disfagi ndonjëherë nuk janë të vetëdijshëm nëse e kanë ose jo. Mund të jetë një ndjesi, që sugjeron vështirësi në kalimin e solideve,



ose lëngjeve nga goja në stomak, mungesë e ndjesisë faringjale ose pamjaftueshmërisë të mekanizmit të gëlltitjes. Disfagia dallohet nga simptomat e tjera, përfshirë këtu odynophagia, e cila përkufizohet...

Suplement

# Vizita e presidentit të Turqisë në Shqipëri: Bashkë në një histori, bashkë në një të ardhme

Nga Abdullah EREN

(Vijon nga faqja 1)

... me vëllezëritë tonë shqiptar, një miqësi e vjetër dhe me lidhje shumë të thella, ku rrënjët e vëllazërisë gjenden në rrugtimin e së shkuarës dhe miqësisë sonë të lashtë. Vëllazëria jonë e të jetuarit bashkë tregojnë se shqiptarët në kohën e Osmanllinjëve kanë arritur poste të larta drejtuese, ku me përkushtimin e treguar shumica prej tyre u bënë Kryeministra që në atë kohë ishin numri dy i shtetit. Solidariteti që kemi pasur që nga koha e Osmanllinjëve vazhdon i pa lëkundur edhe me tej në ditët e sotme.

Sot Republika e Shqipërisë me Republikën e Turqisë janë dy shtete mike dhe të barabarta. Shqipëria është garancia e stabilitetit dhe e paqes në Ballkan, ku Turqia është një ndër mbështetësit kryesor të kësaj vazhdimësie. Në vijëshmeri Turqia dhe Shqipëria kanë vizionin e tyre në një drejtim të përbashkët në fushat sociale, politike, ekonomike dhe ushtarake. Si në çdo fushë edhe në fushën e ekonomisë Shqipëria është partneri më i madh i Turqisë, ku Shqipëria është vendi i investimeve tona më të larta. Marëdhëniet ndërmjet vendeve tona të zhvilluara në 30 vitet e fundit dhe të përfocuara dita ditës në fushat kulturore po e tregojnë natyrshëm vetveten.

Shqipëria dhe Turqia të pasuritë vlera të ngushta kulturore dhe një histori të përbashkët, gjejnë forcën e zhvillimit të mardhënive të



tyre dypalëshe në afrimitetin e kulturave. Si një ndër shtetet vëlla të Republikës së Turqisë, në Shqipëri Kryesia e Diasporës dhe Komiteteve Mike Jashtë Vendi (YTB) e cila operon në fushën e bashkëpunimit kulturor që nga dita e themelimit në vitin 2010 e gjerë më sot, ka realizuar shumë projekte me qëllimin e forcimit të mardhënive dypalëshe. Dhe veçanërisht ajo çka i ka tërhequr vëmendjen Rinisë Shqiptare nga projektet tona të historisë së përbashkët ka qenë përkthimi i librave, sepoziumet, mbështetja në fushën e Arsimit, në fushat Akademike, Shkollat

Rinore, programet e iftareve të muajit Ramazanit dhe projekte në zhvillimin e Gjuhës Turke.

Lëvizja Arsimore është fusha të cilës i kemi dhënë prioritet në forcimin e mardhënive për brezat e ri të dy shteteve. Programi i Bursave të Turqisë i drejtuar nga YTB, ashtu si në Ballkan dhe mbarë botën e veçanërisht tek të rinjtë Shqiptar është tepër i mirënjohur. Me programin e Bursave të Turqisë aktualisht në Universitetet tona në nivelet Bachelor dhe Master studiojnë 230 studentë shqiptar. Që nga viti 1994 deri më sot nga Shqipëria në Turqi me

bursa të plota në degë të ndryshme kanë studiuar afro 1000 student. Më së fundmi në 2021 nga Shqipëria kanë aplikuar 527 student dhe 69 prej tyre kanë fituar të drejtën e studimeve me Bursë të Plotë. Sipas nesh, sa më shumë të rinjtë të aplikojnë në Bursat e Turqisë aq shumë shtohen lidhjet ndërmjet shteteve në fushat e politikës, kulturës dhe ekonomisë.

Ne na është pasqyruar një fat i madh sepse herë pas here bëjmë takime me Shqiptarët e Diplomuar në Turqi që i njohin mirë dy vendet. Në Shqipëri ka të diplomuar në Turqi që kontribuojnë në

pozicione të rëndësishme. Në Shqipëri gjenden rreth 400 të diplomuar, dhe në vitin 2018 në kryeqytet u themelua Shoqata e Diplomuarve në Turqi ku i bë një vlerë e shtuar institucionale për të dy vendet. Studentët të cilët kanë mbaruar në turqi janë të kompletuar me të dyja gjuhët si shqip ashtu edhe turqisht dhe tek zyra e tyre bëjnë të mundur mbështetjen në shumë fusha të ndryshme si turizmi, çështje tregëtie, mbështetje arsimore etj.

Në Shqipëri, një tjetër funksion humanitar i Shoqatës të Diplomuarve në Turqi u pa në vitin 2019. Në vitin

e sipërpërmendur, institucione dhe organizata të ndryshme të Turqisë i dërguan ndihma vëllezëre shqiptar gjatë tërmetit të dhimbshëm që ndodhi në Shqipëri. YTB është një ndër institucionet që dërgon ndihma në Shqipëri nëpërmjet Shoqatës "Shoqata e Të Diplomuarve Në Turqi" ku nga kjo u është ofruar ndihmë për shqiptarët që janë të diplomuar në Turqi. I njëjti qëndrim dashamirës i shoqatës është shfaqur edhe në ndihmën e dhënë nga YTB për Shqipërinë me rastin e Covid-19.

Ne besojmë se fakti që presidenti ynë, Z. Recep Tayyip Erdoğan, do të bëjë vizitën e tij të parë jashtë vendit në vitin 2022 në Shqipëri më 17 janar, do ta çojë në një nivel më të lartë vëllazërinë ekzistuese mes dy vendeve. Kjo vizitë e rëndësishme do të hapë dyert e bashkëpunimeve të mëdha në shumë fusha, shenjat e të cilave i shohim sot. Vizita e Kryeministrit Shqiptar Z. Edi Rama në Turqi rreth një vit më parë, sipas tij, hapi një faqe të re mes dy vendeve. Shpresojmë që vizita e Presidentit të Turqisë në Shqipëri në ditët në vijim të kurorëzojë këtë faqe të re me shumë projekte të përbashkëta me përfitime reciproke. Ne, si Turqi dhe YTB, do të vazhdojmë të shohim kontributet që i kemi dhënë njëri-tjetrit me Shqipërinë gjatë historisë, në përputhje me kërkesat e epokës, për t'i forcuar më tej, jo thjesht për t'i rritur, por për t'i shumëfishuar dhe diversifikuar si kërkesë e miqësisë sonë.

*\* Krytari i Diasporës dhe Komiteteve Mike Jashtë Vendi (YTB).*

g gjitha te rejat nga jeta ipave

çdo të shtëpë falas me GAZETA SHQIPTARE